



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILI I BASENIT UJOR SHKUMBIN**

Nr. 09 Prot

Dt. 04.06.2018

**VENDIM**

Nr. 3, Datë 30 / 05 / 2018

**PËR**

**SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË BASENIT UJOR SHKUMBIN NR.11, DATË 25.04.2017, "PËR MIRATIMIN E LEJES PËR REHABILITIMIN E SHTRATIT TË LUMIT SHKUMBIN" ZONA E "PESHTANIT", BASHKIA ELBASAN, QARKU ELBASAN SUBJEKTIT "PESHTANI" sh.p.k**

Në mbështetje të shkronjës "d", të nenit 109, nenit 113, të Kodit të Procedurave Administrative, shkronjës "c", të pikës 2, të nenit 12, shkronjës "e", të pikës 1, të nenit 55, të ligjit nr.111/2012, datë 15.11.2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", vendimit të Këshillit Kombëtar të Ujit, nr.1, datë 13.1.2010, "Për ndalimin e përkohshëm të dhënies së lejeve të reja për shfrytëzimin e zhavorreve në shtretërit e lumenjve", vendimit të Këshillit Kombëtar të Ujit nr.1, datë 7.7.2011, "Për menaxhimin e shfrytëzimit të zhavorreve për ndërtimin e rrugëve", me propozimin e Kryetarit, Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin.

**V E N D O S I:**

1. Shfuqizimin e vendimit nr.11, datë 25.04.2017, "Për miratimin e lejes për rehabilitimin e shtratit të lumit Shkumbin", zona e "Peshtanit" bashkia Elbasan , qarku Elbasan, subjektit "PESHTANI" sh.p.k
2. Ngarkohet Agjencia e Basenit Ujor Shkumbin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**Maksim MALAJ**

